



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

THIRRJE PUBLIKE PËR FINANCIM TË KUZHINAVE POPULLORE

Konteksti:

Në kuadër të realizimit të masave konkrete të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka planifikuar të ofrojë mbështetje financiare për organizatat jo-qeveritare/entitetet të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategoritë e cenueshme të shoqërisë, përmes kuzhinave popullore. Andaj, nëpërmjet kësaj shpalljeje ftohen të gjitha organizatat jo-qeveritare dhe entitetet tjera që të aplikojnë për mbështetje financiare për financim të aktiviteteve të kuzhinave popullore.

Qëllimi:

Ky aktivitet ka dy qëllime kryesore: E para, të sigurojë financim për vazhdimësinë e punës së kuzhinave popullore që mund të jenë ndikuar nga pandemia dhe, e dyta, të sigurojë që pjesa e konsiderueshme e mjeteve financiare nga ky financim të shpenzohen për blerjen e produkteve bujqësore vendore.

Kushtet që duhet t'i plotësojë aplikuesi:

1. Të jetë organizatë jo-qeveritare apo entitet tjetër (institucion me status të veçantë, bashkësi fetare, institucion publik apo të ngjashme) i regjistruar në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
2. Të ketë zhvilluar aktivitete të kuzhinës popullore para datës 01.07.2021; dhe
3. Të zhvillojë të gjitha aktivitetet e organizatës apo entitetit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Vlera e mbështetjes financiare:

Vlera e mbështetjes financiare për çdo kuzhinë popullore, që aprovohet nga Komisioni, është deri një njëqind mijë euro (100.000 €), varësisht nga kapaciteti dhe intensiteti shërbyes i organizatës apo entitetit. Kjo vlerë e mbështetjes financiare është e dedikuar si në vijim:

- Shtatëdhjetë për qind (70%) për blerjen e produkteve bujqësore (produktet bimore apo shtazore, të cilat prodhohen në fermë dhe ato që rrjedhin nga faza e parë e përpunimit të këtyre produkteve – pemët, perimet, vezët, qumështi); si dhe
- Tridhjetë për qind (30%) për blerjen e produkteve tjera mbështetëse (mielli, buka etj), për zhvillimin e aktivitetit në kuzhinat popullore.

Dokumentet e nevojshme dhe mënyra e aplikimit:

Aplikacionet duhet të dërgohen përmes e-mail adresës zs.mf@rks-gov.net deri më datën **15 shtator 2021, ora 16:00**, dhe duhet të përmbajnë dokumentacionin në vijim:

1. Certifikatën apo dokumentin e regjistrimit;
2. Dëshmi mbi zhvillimin e aktiviteteve të kuzhinës popullore (përmes raporteve të punës, publikimeve mediale, fotografive përkatëse apo të ngjashme);
3. Planin për realizimin e aktiviteteve nga mbështetja financiare (planin e punës, planin biznesor apo të ngjashme).

Procesi i përzgjedhjes:

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të themelojë një Komision të pavarur për shqyrtimin e aplikacioneve. Pas shqyrtimit të aplikacioneve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të lidhë marrëveshje për përcaktimin e përgjegjësisve të palëve me organizatat apo entitetet e aprovuara nga Komisioni.

Palët e interesuara mund të kërkojnë sqarime shtesë për këtë thirrje publike nëpërmjet e-mail adresës zs.mf@rks-gov.net.